REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPESINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ZIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org.jedinica / Org.Unit: 01
Nr.i Prot. / Broj Prot. / Prot. No: 11572
Nr.i Faqeve / Br. Stranica / No.Pages: 1
Data / Datum / Date: 15.12.25
PRISHTINË / A No.2

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

*Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapesinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Zivotne Sredine i Prostornog Planiranja*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapesinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), Nenin 4.10 (shtojca nr.1.10 ) të Rregullores nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 17 dhe 21 të Ligjit për transportin rrugor Nr.04/L-179, nenit 7 të Udhëzimit Nr.09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndërurban të udhëtarëve me autobus, nenin 6 te Udhezimit nr.26/2017 për Subvencionimin e linjave ekonomikisht të paqëndrueshme në transportin nderurban, nxjerr:

**VENDIM**

1. Të bëhet shpallja publike e nisjeve të lira të subvencionuara në transportin ndër-urban, përfshirë afatin e aplikimit , mënyrën e aplikimit dhe tërheqjen e dokumentacionit për aplikim.

2. Të afishohet në Web-faqen e MMPHI-së dhe në tabelë pranë zyrave të DTT-së: Relacioni me oraret e lira për aplikim, kriteret për aplikim dhe kushtet e përgjithshme të shpalljes publike.

3. Detyrohet Departamenti i Transportit Tokësor në zbatimin e këtij vendimi.

**Shtojcë e këtij vendimi janë:**
Lista me nisje te shpallura nëpër regjione, kriteret për aplikim dhe kushtet e përgjithshme të shpalljes publike.

**Izedin Bytyqi**

Sekretar i Përgjithshëm U.D.

**Iu dërgohet:**

**Kabinetit të Ministrit;**
**Sekretarit të Përgjithshëm;**
**Departamentit te Transportit;**
**Arkivit të MMPHI-së**

## Përmbajtja e shpalljes publike.

Shpallja publike për paraqitjen e aplikacioneve për nisje te shpallura në transportin e rregullt publik te udhëtarëve në transportin nder-urban :

## Kushtet për aplikim:

1. Licencë për transport "C" ose "D" të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës për të cilën nuk është iniciuar ndonjë procedurë e pezullimit apo revokimit;

2. Dëshminë për numrin e shoferëve të punësuar (menaxheri i operatorit të transportit nuk mund të paraqitet edhe si shofer për vërtetimin e rendit të udhëtimit):
   -për relacionin deri në 50 km së paku 1 shofer për 3 rende të udhëtimit;
   -për relacionin mbi 50 km së paku një shofer për 2 rende të udhëtimit

3. Dëshminë për kapacitetet përkatëse të autobusëve të destinimit ndër-urban të certifikuar nga MMPHI-ja sipas licencës "C" apo "D" (librezat e qarkullimit te autobusave te noterizuara, kartoni teknik/gjashtëmujor të noterizuara dhe sigurmi i autobusit kopje), kapacitetet teknike të prezantuara në lëndën përkatëse do të kalkulohen në raport me numrin e nisjeve në transportin ndër urban dhe atë ndërkombëtar në evidencat e DTT-së;

4. Vërtetimin (jo më të vjetër se 30 ditë) e organeve kompetente për kontributet e të punësuarve/vërtetimi tatimor, kontrata e punës origjina dhe patenteshoferi kopje, për të punësuarit sipas pikës (2) ;

5. Tri kopje(origjinale) të rendit të udhëtimit për të cilin aplikon sipas formës dhe përmbajtjes së aprovuar nga Ministria.

6. Dëshminë mbi Kompetencën Profesionale për menaxher te operatorit transportues me validitet.

7. Dëshminë se menagjeri i operatorit aplikues është në marrdhënje të rregullt pune, Kotrata e punes origjinale, Pasqyra e kontributeve pensionale apo vertetimi i ATK-së.

8. Me rastin e aplikimit për vërtetimin e rendit të ri të udhëtimit operatori do te paguaj tarifën si vijon :

   - Në relacionin deri në 30 km 10€ ,

- Në relacionin deri në 50 km 20€ ,
- Në relacionin mbi 50 km 30€ ,

9.Dëshmitë për nisjet nëse posedon në transportin ndërurban ( kopjet e rendeve të udhëtimit të vërtetuara nga MMPHI-ja) dhe transportin ndërkombëtar(kopjet e lejeve për operim në transportin ndërkombëtar të vërtetuara nga MMPHI-ja).

**I tërë dokumentacioni i duhet të jetë i noterizuar (përjashtim bëjnë dokumentet te lëshuara nga MMPHI-ja), po ashtu duhet të jetë i vulosur dhe nënshkruar nga menaxheri i operatorit aplikues.**

## Mënyra e Aplikimit:

1. Aplikacioni i plotësuar se bashku me dokumentacion duhet të dorëzohet në Arkivin e MMPHI-së Ish ndërtesa e Gërmisë nga data:
   **15.12.2025 deri me datën:16.01.2026 në ora 12.00**

2. Dokumentacioni dorëzohet në dy kopje ne dy zarfe te veçanta prej te cilave ne njërin zarf është **origjinali** ndërsa ne tjetrin është fotokopja. Zarfet janë te mbyllur dhe shënuar **"te mos hapet".**

3. Komisioni do të zgjedh aplikacionin i cili i ka plotësuar më së miri kriteret e përcaktuara ne shpalljen publike;

4. Hapja e aplikacioneve behet ne objektin e MMPHI-së (Departamenti i Transportit Tokësor me **datën:16.01.2026 në orën:13.30;**

5. Informatat më të hollësishme merren në zyrën **Nr.C109.** Ish ndërtesa e Gërmisë.
   **Tel. 038 211 547,038 211 546.**

6. Aplikacioni i pa kompletuar si dhe pa nënshkruar dhe pa vulosur nga menaxheri i operatorit transportues nuk do të shqyrtohet fare dhe do të konsiderohet i anuluar.

## REGJIONI I MITROVICËS

Relacioni:- Mitrovice e Jugut-Leposavic-Jarinje

| | 1 | 2 | 3 |
|---|---|---|---|
| Nisja ; | /06;00/ | /06;30/ | /07;30/ |
| Kthimi | /16;15/ | /14;00/ | /16;30/ |

Relacioni:- Mitrovice e Jugut-Zubin Potok-Bernjak

| | 1 | 2 | 3 |
|---|---|---|---|
| Nisja ; | /06;30/ | /07;00/ | /10;30/ |
| Kthimi | /16;15/ | /14;00/ | /16;30/ |

Relacioni:- Mitrovice e Jugut-Kroi I Vitakut-Zhazhe

| | 1 | 2 | 3 |
|---|---|---|---|
| Nisja ; | /06;00/ | /10;30/ | /14;30/ |
| Kthimi | /16;15/ | /14;00/ | /16;30/ |

Relacioni:- Mitrovice e Jugut-Bistrice-Ceraje

| | 1 | 2 | 3 |
|---|---|---|---|
| Nisja ; | /06;00/ | /10;30/ | /14;30/ |
| Kthimi | /16;15/ | /14;00/ | /16;30/ |

Relacioni:- Mitrovice e Jugut-Bistrice-Ceraje

| | 1 | 2 | 3 |
|---|---|---|---|
| Nisja ; | /06;00/ | /10;30/ | /14;30/ |
| Kthimi | /16;15/ | /14;00/ | /16;30/ |

Relacioni:Mitrovicë e Jugut - Doljane - Banjskë - Ballaban - Pllandishë - Vuçë - Soçanicë - Dren - Cërnatovë - Bello Bërdo

| | 1 | 2 | 3 |
|---|---|---|---|
| Nisja ; | /06;00/ | /10;30/ | /14;30/ |
| Kthimi | /16;15/ | /14;00/ | /16;30 |